



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

**STRATEGJIA SHITETËRORE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN
E TERRORIZMIT**

2023 - 2028

Maj, 2023

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
2. HYRJE	4
2.1. Qëllimi	5
2.2. Vizioni.....	5
3. Metodologjia	5
4. Lista e përkufizimeve dhe shkurtesave	6
4.1. Lista e shkurtesave	7
5. Parimet e Përgjithshme.....	8
6. Analiza e situatës aktuale.....	9
7. OBJEKTIVAT.....	14
7.1. PARANDALIMI	14
7.2. MBROJTJA	18
7.3. NDJEKJA.....	20
7.4. REAGIMI.....	22
8. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË	24
9. Korniza ligjore dhe institucionale	25
9.1. Korniza ligjore	25
9.2. Korniza institucionale.....	26

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Kosovës, duke u bazuar mbi vlerat dhe standardet më të larta demokratike, synon të ndërtojë një ambient ku liria dhe siguria e njerëzve janë të garantuara dhe të mbrojtura. Sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore, liria e shprehjes, e fesë, trajtimi i barabartë dhe respektimi i diversitetit janë parimet bazë mbi të cilat ndërtohet shoqëria jonë. Andaj, reagimi efikas me qëllim të parandalimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm kërkon përfshirjen dhe bashkëpunimin e të gjitha institucioneve publike, shoqërisë civile, grupeve të interesit organizatave ndërkombëtare dhe qytetarëve.

Terrorizmi vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore të sigurisë vendore dhe globale. Kjo dukuri paraqet kërcënim jo vetëm për jetën dhe pronën, por edhe për vlerat themelore demokratike mbi të cilat është ndërtuar Republika e Kosovës. Andaj, politika shtetërore e Republikës së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit bazohet në kundërshtimin dhe luftimin e të gjitha akteve dhe formave të terrorizmit, pavarësisht rrethanave, vendndodhjes, kohës dhe mënyrës së kryerjes.

Kjo Strategji Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit është dokumenti i katërt strategjik i hartuar nga Republika e Kosovës me qëllim të parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Duke u bazuar në vlerësimet e kryera, trendet rajonale dhe globale, si dhe në linjë me politikat dhe orientimet e partnerëve strategjik të Republikës së Kosovës, kjo Strategji bazohet në katër objektiva strategjike si në vijim:

- I. **PARANDALIMI:** Synon parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, përmes identifikimit dhe adresimit të shkaqeve rrënjësore, përkatësisht në kundërvënien e ideologjive të dhunshme ekstremiste apo radikale, të cilat inkurajojnë individët apo grupet të justifikojnë dhe praktikojnë dhunën si mjet në arritjen e qëllimeve të tyre, si dhe zvogëlimin e mundësive të kryerjes së sulmeve terroriste.
- II. **MBROJTJA:** Synimi i këtij objektivi strategjik është mbrojtja efikase nga kërcënimet apo sulmet terroriste ndaj Republikës së Kosovës apo ndaj interesave të saj në rajon dhe më gjerë si dhe minimizimin e cenueshmërisë nga ky fenomen.
- III. **NDJEKJA:** Përmes së cilës institucionet e zbatimit të ligjit do të identifikojnë, hetojnë dhe zbulojnë veprat penale të terrorizmit dhe financimit të terrorizimit dhe sjellin para drejtësisë individët apo grupet që paraqesin kërcënim terrorist apo kryejnë akte terroriste.
- IV. **REAGIMI:** Ka për qëllim përgatitjen e institucioneve të Republikës së Kosovës për menaxhimin dhe minimizimin e pasojave të sulmeve terroriste, duke përmirësuar aftësinë

për t'u përballur me pasojat, koordinimin e reagimit, mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave.

2. HYRJE

Terrorizmi, me të gjitha format e tij, pavarësisht motivit dhe origjinës, vazhdon të përbëjë kërcënim për paqen, sigurinë dhe rendin kushtetues në Republikën e Kosovës. Kjo dukuri, e cilat vazhdimisht evoluon, nuk kërcënon vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe mënyrën e jetesës në shoqëri. Republika e Kosovës, si përgjigje ndaj kërcënimeve dhe pasojave eventuale nga terrorizmi, në vitin 2009 ka hartuar strategjinë e parë kundër terrorizmit, e cila përveç se ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucional, ka ofruar edhe një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Që nga ajo kohë, përgjigjia institucionale e Republikës së Kosovës ndaj terrorizmit ka evoluuar, duke i avancuar kapacitetet njerëzore dhe institucionale.

Megjithëkëtë, zhvillimet vendore dhe ndërkombëtare imponojnë nevojën për hartimin e një dokumenti të ri strategjik, gjithëpërfshirës, i cili do të jetë në gjendje të forcojë reagimin e Republikës së Kosovës për të **parandaluar, mbrojtur, ndjekur** dhe **reaguar** edhe më suksesshëm ndaj terrorizmit. Për këtë qëllim është hartuar ky dokument strategjik, i cili është në linjë me parimet e Agjendës kundër Terrorizmit për BE-në 2020, si dhe me politikat dhe orientimet e partnerëve strategjik të Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës bën analiza të vazhdueshme të arritjeve të deritashme dhe përmes kësaj Strategjie do të vazhdojë me programet ekzistuese të de-radikalizimit dhe shkëputjes, krahas atyre për rehabilitimin dhe ri-integrimin e luftëtarëve të huaj, familjeve të tyre që kthehen nga luftërat e huaja dhe personave të përfshirë në aktivitete terroriste.

Me anë të kësaj Strategjie do të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e subjekteve përgjegjëse dhe format e ndërveprimit të tyre, ku rol i veçantë do t'i kushtohet autoriteteve të nivelit lokal. Strategjia, përmes aktiviteteve specifike, synon ngritjen e kapaciteteve dhe përfshirjen më të madhe të nivelit lokal si dhe të shoqërisë civile në realizimin e objektivave strategjik.

Kujdes të veçantë Strategjia do t'i kushtojë përfshirjes së gruas dhe respektimit të standardeve të barazisë gjinore. Së fundmi, gratë gjithnjë e më shumë përmes ideologjive të dhunshme ekstremiste po nxiten drejt mbështetjes së aktiviteteve terroriste dhe kryerjes së tyre. Strategjia synon fuqizimin e grave në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, përmes përfshirjes më të madhe në vendimmarrje, fuqizimit ekonomik e social, uljes së papunësisë dhe sigurimit të mundësive të barabarta në shoqëri.

Republika e Kosovës do të vazhdojë të jetë pjesë aktive në luftën globale kundër terrorizmit dhe financimit të tij, përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të ngushtë me partnerët dhe mekanizmat ndërkombëtarë që trajtojnë këtë fushë. Për të reaguar ndaj të gjitha formave të

terrorizmit, Republika e Kosovës dhe institucionet e saj udhëhiqen nga Strategjia Globale e Kombeve të Bashkuara kundër Terrorizmit, e cila është udhërrëfyes për çdo përpjekje për t'iu kundërvënë këtyre dukurive. Autoritetet shtetërore janë duke zbatuar edhe Marrëveshjen me Komisionin Evropian për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor, vlefshmëria dhe vazhdimi i të cilit është zgjatuar në tetor 2020.

Institucionet e Republikës së Kosovës do të vazhdojnë të sigurojnë ambient të sigurtë drejt ndërtimit të një shoqërie demokratike, ku respektimi i të drejtave e lirive themelore të njeriut është parakusht i çdo veprimi. Në këtë drejtim, për zbatimin e këtij dokumenti institucionet shtetërore udhëhiqen nga parimet dhe vlerat kushtetuese, instrumentet ndërkombëtare dhe praktikrat më të mira për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave e të lirive të njeriut.

2.1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj Strategjie është të mbrojë Republikën e Kosovës, qytetarët, vlerat dhe interesat e saj nga kërcënimet e terrorizmit, përmes orientimit të politikave dhe forcimit të qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

2.2. Vizioni

Ruajtja e ambientit të sigurt në Republikën e Kosovës duke parandaluar dhe luftuar terrorizmin, bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese për të gjithë njerëzit.

3. Metodologjia

Strategjia për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023 - 2028 është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, gjatë të cilit janë konsultuar të gjithë akterët relevant. Me vendimin nr. 017/2022 të datës 12 janar 2022 të Sekretares së Përgjithshme të MPB-së, është themeluar Grupi i Punës, pjesë e të cilit kanë qenë institucionet relevante të Republikës së Kosovës, përfaqësues nga komuniteti ndërkombëtar prezent në Republikën e Kosovës, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe palë tjera të interesit.

Grupi i Punës është themeluar me qëllim të hartimit të një Strategjie të re, duke u bazuar në Strategjinë Shtetërore kundër Terrorizmit 2018 - 2023 dhe Strategjinë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 - 2020.

Përveç këtyre dy dokumenteve, kjo Strategji është hartuar edhe duke marrë për bazë zhvillimet globale dhe rajonale nga fusha e parandalimit dhe luftimit të terrorizmit, vlerësimet e situatës të përgatitura nga Policia e Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Vlerësimet të Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krime i Organizuar (SOCTA), raportet e vendit të Departamentit të Shtetit Amerikan, raportet e Komisionit Evropian për Kosovën, raporteve të EUROPOL-it për situatën e terrorizmit dhe trendeve në BE, si dhe dokumentet tjera relevante.

Me qëllim të përafrimit të politikave strategjike dhe legjislacionit vendor në fushën e terrorizmit me ato të Bashkimit Evropian, kjo strategji është hartuar në linjë me parimet e Agjendës kundër Terrorizmit për BE-në 2020. Gjatë procesit të hartimit janë konsultuar edhe strategjitë përkatëse të partnerëve strategjik të Republikës së Kosovës siç janë strategjitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Mbretërisë së Bashkuar si dhe të shteteve të rajonit. Procesi është zhvilluar dhe koordinuar në bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerët zhvillimor.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka përfshirë këto faza kryesore:

- Mbledhja e të dhënave, shqyrtimi dhe analizimi i problemeve, përfshirë analiza mbi zbatimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm 2015 - 2020;
- Organizimi i takimeve informuese të grupit të gjerë të punës;
- Punëtori për prezantimin e të gjeturave nga shoqëria civile mbi zbatimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm 2015 - 2020;
- Hartimi i pjesës narrative të Strategjisë;
- Hartimi i Planit të Veprimit të Strategjisë;
- Organizimi i procesit të konsultimit paraprak dhe atij me publikun.

Strategjia është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit si dhe me Rregulloren (QRK) nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik.

Strategjia për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizimit është përgatitur duke u bazuar në përmbajtjen dhe prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030 dhe Strategjinë e Sigurisë së Kosovës.

4. Lista e përkufizimeve dhe shkurtesave

Terrorizëm, veprim terrorist apo vepër terroriste - nënkupton kryerjen e një ose më shumë veprave penale të listuara në nenin 128 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare.

Grup Terrorist - nënkupton grupin e strukturuar prej më shumë se dy (2) personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit.

Grup i Strukturuar - nënkupton një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role formalisht të përcaktuara për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë ose strukturë të ndërtuar.

Terrorist - nënkupton çdo person fizik i cili: (i) kryen veprim terrorist me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi; (ii) organizon apo drejton të tjerët për të kryer veprime terroriste; ose (iii) kontribuon në kryerjen e veprimeve terroriste nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët, ku kontributi bëhet me dashje dhe me qëllim të avancimit të veprimit terrorist ose me njohjen e qëllimit të grupit për të kryer një veprim terrorist.

Ekstrem, Ekstremizmi: mund të përkufizohet vetëm në lidhje me ideologjinë më të gjerë, që vepron p.sh. në kuadër të nacionalizmit ekstrem, ambientalizmit ekstrem, ekstremizmit fetar. Tipari përkufizues i ekstremizmit është refuzimi i një ose më shumë parimesh bazë të ideologjisë së saj kryesore. Një nationalist i cili i konsideron pjesëtarët e të gjitha kombeve të tjera si inferiorë, ose që refuzon mundësinë e bashkëjetesës, apo beson se të tjerëve duhet t'u mohohen të drejtat, është një nationalist ekstrem. Një besimtar fetar i cili dënon udhëheqësit ose pjesën më të madhe të anëtarëve të besimit të tij është një ekstremist. Ekstremistët nuk janë medoemos të dhunshëm.

Radikalizmi: është një proces me faza dhe kompleks në të cilin një individ ose një grup përfaqon një ideologji ose besim radikal që pranon, përdor ose lejon dhunën, duke përfshirë aktet e terrorizmit, për të arritur një qëllim të caktuar politik ose ideologjik.

Ekstremizmi i dhunshëm: i referohet veprimtarisë së individëve ose grupeve që përdorin ose përkrahin frikën, terrorin ose dhunën për të provuar të arrijnë qëllimet e tyre ideologjike, religjioze, politike.

4.1. Lista e shkurtesave

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar
AKF	Agjencia e Kosovës për Forenzikë
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKMRRSB	Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore
AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BIK	Bashkësia Islame e Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
ICITAP	Programi për ndihmë ndërkombëtare në trajnim për hetim të krimit
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MD	Ministria e Drejtësisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MB	Ministria e Mbrojtjes
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MTI	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
OPDAD	Zyra Tejoqenaike për Zhvillimin, Asistencën dhe Trajnimin e Prokurorisë OSBE
	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSH	Prokuroria e Shtetit
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SKSK	Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
SHSKUK	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave

5. Parimet e Përgjithshme

Strategjia bazohet në këto parime:

Parimi i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë - veprimet e ndërmarra për të parandaluar dhe luftuar terrorizmit bazohen në dispozitat e parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.

Parimi i qasjes gjithëpërfshirëse - parandalimi dhe luftimi efektiv i kërcënimeve terroriste arrihet përmes qasjes gjithëpërfshirëse ndaj këtij fenomeni nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, komunitetet, shoqërisë civile, grupeve përfaqësuese, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare.

Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut - nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

Parimi i konfidencialitetit - institucionet përgjegjëse në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit do të sigurojnë ruajtjen e informatave të mbledhura/siguruara gjatë procesit të hetimeve dhe aktiviteteve tjera të këtyre institucioneve në kuadër të parandalimit dhe luftimit të terrorizmit.

Parimi i transparencës – Institucionet e Republikës së Kosovës, gjatë implementimit të kësaj Strategjie do të respektojnë parimin e transparencës, në përputhje me kornizën ligjore të zbatueshme.

Parimi i bashkëpunimit – Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar në lehtësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve midis institucioneve vendore dhe akterëve tjerë të përfshirë.

Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar – Republika e Kosovës është partner i besueshëm dhe kredibil në luftimin e terrorizmit. Që nga viti 2014, Kosova është anëtare aktive e Koalicionit Global për të mposhtur ISIS-in,¹ ndërsa që nga viti 2019 është duke e zbatuar edhe Planin e Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor me Komisionin Evropian.²

6. Analiza e situatës aktuale

6.1. Konteksti ndërkombëtar

Kërcënimi nga terrorizmi është duke evoluar vazhdimisht. Globalisht, grupet terroriste dhe rrjetet e të gjitha ideologjive vazhdojnë të zhvillohen në mënyrë organike, duke përfshirë shfrytëzimin e zhvillimeve teknologjike për të çuar përpara objektivat e tyre strategjike.

Bazuar në trendet globale, janë duke u themeluar grupe, lëvizje dhe organizata të reja terroriste me motive që fillojnë nga ato ideologjike, socio-ekonomike, racore, gjinore, kulturore, politike deri te ato fetare dhe shumica e atyre që tanimë ekzistojnë po ndahen në entitete të reja. Për më tepër, individët që pajtohen me ideologjitë e grupeve, lëvizjeve dhe organizatave terroriste dhe që ndërkohë nuk janë të lidhur nga jashtë me ndonjë entitet të caktuar, ende mund të paraqesin kërcënim siç janë "*individët që veprojnë të vetëm*".³

Ekzistimi i një grupi me shtrirje të gjerë të ideve dhe narrativave është një faktor i rëndësishëm në motivimin e entiteteve terroriste të të gjitha llojeve, duke përfshirë Daesh-in, Al Kaida, grupet, organizatat dhe lëvizjet e ekstremit të djathtë dhe të majtë. Propaganda e tyre frymëzon edhe individë të cilët nuk kanë asnjë lidhje formale me ndonjë grup të caktuar. Në vlerësimet e Indeksit Global të Terrorizimit, subjektet që nuk janë të lidhur në mënyrë formale me organizata, i kryejnë shumicën e sulmeve të motivuara nga ideologjitë e ekstremit të majtë ose të djathtë.⁴ Edhe pse individët mund të tërhiqen nga grupet terroriste edhe për arsye sociale, kulturore, materiale, psikologjike dhe të tjera, ideologjia ende mbetet shtytës i fortë.

¹ <https://theglobalcoalition.org/en/partner/kosovo/>

² https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2018-10/20181005_joint-action-plan-counter-terrorism-western-balkans.pdf

³ "Lone actors"

⁴ <https://reliefweb.int/report/world/global-terrorism-index-2022>

Në vitin 2014, grupi terrorist Daesh shfrytëzoi brishtësinë politike dhe luftën civile për të kontrolluar sipërfaqe të mëdha të territorit në Siri dhe Irak, duke shpallur të ashtuquajturin "Kalifat", ndërsa shtypte brutalisht popullsinë lokale dhe shkaktonte krizë të madhe humanitare. Shumë nga personat që udhëtuan në këto rajone për të marrë pjesë në luftëra, vazhdojnë të mbahen nëpër kampe në veri-lindje të Sirisë. Për komunitetin ndërkombëtar, një nga çështjet më urgjente të sigurisë është se si këta individë mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës, hetimi i përfshirjes së tyre të mundshme në kryerjen e akteve terroriste, dhe në fund se si ata dhe anëtarët e familjes që kanë udhëtuar me ta mund të rehabilitohen në mënyrë të sigurt dhe të ri-integrohen në shoqërinë e tyre.

6.2. Situata në Kosovë

Terrorizmi, në të gjitha format e tij përbën një kërcënim për sigurinë kombëtare, rajonale dhe globale, duke kërcënuar paqen dhe sigurinë dhe duke minuar sistemin demokratik. Dinamika në aspektin e terrorizmit si dhe sfidat dhe kërcënimet me të cilat ballafaqohen sot institucionet e Republikës së Kosovës, janë më të ndryshme se në vitet paraprake. Ndër sfidat dhe kërcënimet e reja të mundshme janë indikacionet që vijnë nga grupe, lëvizje dhe organizata pa dallim, të cilat synojnë de-stabilizimin e situatës së sigurisë, rendit demokratik dhe kohezionit social, pa përjashtuar mundësinë e sulmeve terroriste në Republikën e Kosovës për të arritur qëllimet e tyre.

Republika e Kosovës, përveç që sfidohet me forma të tjera të aktiviteteve terroriste, si ajo me motive nacionaliste dhe politike si dhe me tendenca për të ndërhyrë në rendin kushtetues të Kosovës nga shtetet jomiqësore, po përballet edhe me terrorizmin me motive fetare. Ndonëse, evoluimi i terrorizmit ka pësuar ndryshime, institucionet e Republikës së Kosovës kanë ndërmarrë veprime, si në aspektin e rregullimit ligjor dhe institucional, ashtu edhe në punën me komunitetin për të zhvilluar një qasje bashkëpunuese për t'iu kundërvënë ideologjive dhe narrativave që përhapen nga grupet, lëvizjet dhe organizatat terroriste.

Vështruar nga prizmi i zhvillimeve të kohëve të fundit në Kosovë, rreziku nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm me motive fetare që shpie në terrorizëm, vlerësohet që është në ulje, ndërkohë që rreziku nga aktivitetet dhe sulmet eventuale me elemente të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit me motive politike apo nacionaliste është në ngritje, sidomos në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Sfidimi i hapur i institucioneve (veçanërisht atyre të sigurisë) në veri, përmes sulmeve ndaj policisë, barrikadimeve, krijimit dhe mbajtjes së organizatave ilegale (dhe të armatosura) me qëllim përdorimin e tyre për kundërvënie të dhunshme dhe sulme ndaj policisë dhe institucioneve tjera, rritja e propagandës dhe retorikës nxitëse nga qarqe jo miqësore të Republikës së Kosovës, janë duke krijuar parakushte për kryerjen e akteve të tilla, duke shtuar gjithnjë e më shumë rrezikun që akte të tilla të ndodhin në vazhdimësi.

6.3. Vlerësimi i nivelit të rrezikut dhe parandalimi i sulmeve terroriste në vend

Përkundër masave të ndërmarra ndër vite për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit në vend, institucionet e Republikës së Kosovës janë të vetëdijshme për rreziqet potenciale aktuale dhe kanë orientuar përgatitjen dhe gatishmërinë për reagim, bazuar në vlerësimin e nivelit të rrezikut prej tyre. Terrorizmi me motive nacionaliste është ndër sfidat dhe kërcënimet që rrezikojnë sigurinë e vendit tonë. Grupet, lëvizjet dhe organizatat pa dallim kanë për qëllim të destabilizojnë situatën e sigurisë, rendin demokratik dhe kohezionin social.

Sa i përket terrorizmit me bazë nacionaliste, përkundër progresit që është bërë në marrëdhëniet ndëretnike ndërmjet dy komuniteteve më të mëdha në Republikën e Kosovës, tensionet vazhdojnë të jenë prezentë dhe ka grupe, lëvizje dhe organizata, të cilat herë pas here janë të predispozuar për të ushtruar dhunë për arritjen e qëllimeve politike, si dhe për të provokuar incidente ndëretnike, ndonjëherë me mbështetjen edhe të vendeve të treta. Grupet, organizatat dhe lëvizjet që promovojnë separatizmin kryesisht kanë të bëjnë me zhvillimet politike nëpër të cilat ka kaluar Republika e Kosovës gjatë rrugëtimit të saj në procesin e shtet ndërtimit dhe aktualisht është e fokusuar kryesisht në veri të vendit, por me tendencë të shtrirjes edhe në rajone të tjera të vendit.

Aktivitetet e grupeve, organizatave dhe lëvizjeve me ndikim në Kosovë ndërlidhen edhe me kërcënimet hibride, përkatësisht me përhapjen e propagandës dhe dezinformimit me qëllim të dëmtimit të imazhit dhe interesave të Republikës së Kosovës. Nëpërmjet propagandës së tillë dhe publikimit të lajmeve të rreme, synohet rritja e pasigurisë tek qytetarët e vendit, krijimi i një klime të favorshme për de-stabilizimin e situatës së sigurisë dhe tendenca për ta paraqitur Republikën e Kosovës si ambient të favorshëm për terrorizëm.

Në anën tjetër, si rezultat i ideologjive islamiste të përhapura në Kosovë nga vendet e Lindjes së Mesme, terrorizmi vazhdon të jetë kërcënim për sigurinë e vendit. Niveli i kërcënimit të sulmeve të mundshme terroriste nga anëtarët e organizatave terroriste nëpërmjet luftëtarëve të huaj terroristë, celulat e fjetura ose nga simpatizantët dhe mbështetësit që mund të frymëzohen për të kryer akte terrorizmi mbetet i ulët, me tendenca të rritjes së tyre në prag të ngjarjeve/datave të rëndësishme, sidomos gjatë festave dhe ngjarjeve simbolike.

Pavarësisht zhvillimeve në zonat e konfliktit në Lindjen e Mesme dhe humbjes së kontrollit të territoreve nga organizatat terroriste, ideologjia e tyre terroriste vazhdon të jetë aktive, sidomos në platforma dhe aplikacione të ndryshme online, ku propaganda në mbështetje të organizatave terroriste përfshin përkthimet e materialeve të tyre propaganduese në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë gjuhët e rajonit si dhe gjuhën shqipe.

Nga shembujt e shumtë në nivel global, individët e radikalizuar mund të kryejnë akte dhune kundër popullatës dhe institucioneve të shtetit të tyre, të cilat synojnë të ndikojnë në qeverinë dhe/ose komunitetet në avancimin e ideologjive terroriste, prandaj nuk mund të përjashtohet rreziku që Kosova mund të jetë në shënjestër të një sulmi të tillë terrorist.

Një aspekt tjetër që vazhdon të ketë ende ndikim në përhapjen e ideologjive terroriste në vendin tonë është mbështetja, frymëzimi dhe financimi i organizatave, grupeve, lëvizjeve dhe individëve të ndryshëm, nga aktorë të jashtëm shtetërorë dhe jo-shtetërorë. Parandalimi i përhapjes së ideve, qasjeve radikale, financimit dhe propagandës, duhet të jetë pjesë e një angazhimi të të gjithë shoqërisë, në kontekstin e kundërvënies së të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Ndër veprimet potenciale që mund të provokojnë thellimin e divergjencave fetare dhe akte tjera kundërvënëse janë edhe deklaratimet publike fyese apo provokuese kundër një komuniteti të caktuar fetar, djegia e librave fetar apo akte tjera të cilat kanë apo mund të kenë për qëllim apo efekt reagimin e grupeve tjera religjioze, gjë që mund të shpije në përshkallëzim të ndasive dhe zbehjes së tolerancës fetare që ka karakterizuar dhe karakterizon qytetarët e Kosovës. Andaj, promovimi tolerancës fetare si vlerë tradicionale dhe e njohur për qytetarët e Kosovës, duhet stimuluar tutje, për të ulur rastet e deklaratimeve apo akteve provokative eventuale si dhe duke minimizuar reaksionin apo pasojat tjera të tyre.

6.4. Reagimi i institucioneve të Republikës së Kosovës

Republika e Kosovës ka identifikuar me kohë kërcënimet që vijnë nga ideologjitë ekstremiste dhe terrorizimi, duke marrë edhe masa konkrete për të parandaluar dhe luftuar përhapjen e ideologjive të tilla që synojnë të radikalizojnë individët për një sërë kauzash. Masat e ndërmarra kanë ndikuar që Republika e Kosovës të vlerësohet nga raportet ndërkombëtare si lider në nivel rajonal dhe më gjerë, në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.⁵

Për të reaguar ndaj të gjitha aspekteve të terrorizmit, Republika e Kosovës dhe institucionet e saj udhëhiqen nga Strategjia Globale e Kombeve të Bashkuara kundër Terrorizmit, e cila është udhërrëfyes për çdo përpjekje për t'iu kundërvënë këtyre dukurive. Autoritetet shtetërore janë duke zbatuar edhe Marrëveshjen me Komisionin Evropian për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor.

➤ Parandalimi i përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit

Është zbatuar Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 - 2020, e cila u fokusua në fushën e parandalimit, duke minimizuar faktorët shtytës që mund të ndikojnë në radikalizmin, de-radikalizmin e personave të radikalizuar dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri. Në këtë drejtim, të gjithë akterët e përfshirë kanë ofruar programe dhe aktivitete të tjera përkatëse në mënyrë që të parandalojnë ideologjitë ekstremiste.

⁵ State Department <<https://www.state.gov/reports/country-reports-on-terrorism-2020/kosovo/>>; EU Commission Country Report Kosovo 2021 <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en>

➤ **Avancimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale**

Me qëllim të respektimit të standardeve ndërkombëtare, Republika e Kosovës ka ndërmarrë veprime konkrete për avancimin e kornizës ligjore dhe institucionale në luftën kundër terrorizmit. Kosova në vitin 2015 miratoi ligjin për ndalimin e përfshirjes në konflikte të armatosura jashtë territorit shtetëror.⁶ Gjatë rishikimit të Kodit Penal në vitin 2018, është futur një vepër e re penale (neni 137, Udhëtimi për qëllime terrorizmi), e cila është në përputhje me Direktivën e BE-së për Luftimin e Terrorizmit (Direktiva 2017/541).⁷ Gjithashtu, në fund të vitit 2022 është miratuar një ligj i ri për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të synuara, duke prezantuar zhvillimet dhe standardet më të fundit ndërkombëtare në këtë fushë.⁸

Janë themeluar struktura të reja për ngritjen e kapaciteteve për t'iu përgjigjur kërcënimeve të mundshme nga terrorizmi. Është krijuar një Divizion i posaçëm brenda MPB-së për ri-integrimin dhe rehabilitimin e personave të kthyer nga zonat e konfliktit, janë caktuar koordinator/pika kontakti nga institucionet relevante, etj.

➤ **Ndjekja dhe procedimi penal**

Institucionet e zbatimit të ligjit kanë ndërmarrë veprime konkrete në parandalimin dhe pengimin e aktiviteteve terroriste, sulmeve terroriste, hetimin, arrestimin dhe ndjekjen penale të personave për të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm se kanë kryer ose po përgatiten të kryejnë vepra penale të terrorizmit dhe ato që lidhen me terrorizmin. Edhe në raportet ndërkombëtare, Kosova vlerësohet të jetë ndër shtetet më aktive në Ballkan për ndjekjen penale të individëve të dyshuar për kryerjen ose mbështetjen e aktiviteteve terroriste.⁹

➤ **Riintegrimi i të kthyerve nga zonat e konfliktit**

Institucionet e Republikës së Kosovës, në koordinim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, janë angazhuar dhe kanë kthyer në Kosovë një numër të personave nga zonat e konfliktit. Fillimisht, është bërë një analizë e detajuar në lidhje me avantazhet dhe kërcënimet në rast të kthimit të mundshëm të luftëtarëve terroristë të huaj dhe familjeve të tyre nga zona e konfliktit. Të gjithë të kthyerit i janë nënshtruar procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi si dhe me programet për rehabilitim dhe riintegrim. Bazuar në planin për riintegrim, krahas masave ligjore të marra ndaj të rriturve, vëmendje e posaçme i është kushtuar grave dhe fëmijëve.

Megjithatë, zhvillimet aktuale në këtë fushë, imponojnë nevojën për reagime të reja në parandalimin dhe pengimin e kërcënimeve nga fenomeni i terrorizmit. Në situatën aktuale,

⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10763>

⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68497>

⁹ State Department <<https://www.state.gov/reports/country-reports-on-terrorism-2020/kosovo/>>; EU Commission Country Report Kosovo 2021 <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en>

përmes kësaj Strategjie, përveç parandalimit të kërcënimeve të drejtpërdrejta nga aktet e dhunshme, një fokus i veçantë do t'i kushtohet edhe shkaqeve dhe faktorëve që çojnë individët drejt terrorizmit, duke përfshirë theksin në zhvillimin e programeve psiko-sociale, socio-ekonomike, programet e risocializimit dhe aspektet e edukimit dhe ndërgjegjësimit. Prandaj, institucionet e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, shoqërië civile dhe akterët tjerë, do të orientojnë potencialin drejt krijimit të një shoqërie të pastër nga të gjitha format e terrorizmit.

7. OBJEKTIVAT

Kërcënimet nga terrorizmi janë të vazhdueshme, prandaj parandalimi dhe luftimi i tyre kërkon angazhim dhe punë të vazhdueshme, si dhe zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve. Përkundër faktit se institucionet e Republikës së Kosovës kanë arritur rezultate të kënaqshme në ngritjen e kapaciteteve dhe efikasitetit në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, konteksti aktual në Kosovë, si dhe trendi i zhvillimeve globale, të cilat mund të ndikojnë edhe në Republikën e Kosovës, e bën të domosdoshëm këtë dokument strategjik për parandalimin dhe luftimin efektiv të terrorizmit.

Bazuar në efektivitetin dhe rezultatet e strategjive të mëparshme, si dhe vlerësimet për pesë vitet e ardhshme, aktivitetet e institucioneve të Republikës së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit mbeten të përqendruara në katër objektiva strategjike:

- **PARANDALIMI**
- **MBROJTJA**
- **NDJEKJA**
- **REAGIMI**

7.1. PARANDALIMI

Duke u bazuar në vlerat demokratike dhe standardet e respektimit të të drejtave të njeriut, qëllimi i këtij objektivi strategjik është parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, përmes identifikimit dhe adresimit të shkaqeve rrënjësore, përkatësisht në kundërvënien e ideologjive të dhunshme ekstremiste apo radikale, të cilat inkurajojnë individët apo grupet, të justifikojnë dhe praktikojnë dhunën si mjet në arritjen e qëllimeve të tyre, si dhe zvogëlimin e mundësive të kryerjes së sulmeve terroriste. Përveç përfshirjes së institucioneve shtetërore për arritjen e qëllimit të këtij Objektivi, kërkohet mobilizim gjithëpërfshirës i tërë shoqërisë në minimizimin ose eliminimin e shpërfaqjes së ideologjive që çojnë individët drejt terrorizmit.

Treguesi i ndikimit	Burimi	Përshkrimi i treguesit	Vlera bazë 2022	Caku 2025	Caku 2028
---------------------	--------	------------------------	-----------------	-----------	-----------

Përqindja e personave të identifikuar që përfshihen në Programin e MPB-së për Rehabilitim dhe Riintegrim	MBP, Raportet për zbatimin e Strategjisë për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit	Përmes përfshirjes në programin për Rehabilitim dhe Riintegrim, do të synohet arritja e rehabilitimit dhe përfshirja në shoqëri e personave të radikalizuar dhe të familjeve të tyre	71%	Më shumë se 75%	Më shumë se 80%
Numri i komunave që kanë mekanizma lokal referuese, të funksionalizuar	MPB, Raportet për zbatimin e Strategjisë	Fuqizimi përfshirjes dhe rolit të nivelit lokal në Parandalim përmes krijimit të ekipeve referuese në nivel të komunave dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre	1 komunë	Së paku 3 komuna	Së paku 6 komuna

Në kuadër të objektivit strategjik të Parandalimit, janë katër objektiva specifike, si më poshtë:

1. Identifikimi dhe adresimi i rrethanave që qojnë në ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizëm që shpie në terrorizëm dhe minimizimi i ndikimit të tyre

Ky objektivi specifik synon të sigurojë se institucionet shtetërore dhe shoqëria i identifikojnë dhe adresojnë rrethanat që mundësojnë një ambient të favorshëm për të gjitha format e terrorizmit. Sukses në këtë drejtim zbut shkaqet rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm përpara se grupet ose individët të bëhen të rrezikuar shpesh përmes zbatimit të programeve që adresojnë nevojat themelore njerëzore përkatësisht shoqërore. Për arritjen e këtij objektivit specifik, do të ndërmerren veprime në drejtim të:

- Rritjes së kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe subjekteve të tjera të përfshirë në proces në identifikimin dhe adresimin e faktorëve;
- Ndërmarrjes së veprimeve në adresimin e faktorëve të njohur shtytës si: marginalizimi, diskriminimi, korrupsioni, mungesës së përkatësisë, dhe
- Rritjes së përfshirjes së nivelit lokal.

2. Sfidimi i ideologjive dhe narrativave të grupeve terroriste dhe mbështetësve të tyre

Ky objektivi specifik synon të sigurojë se institucionet shtetërore dhe shoqëria janë të familjarizuar me mënyrat se si grupet terroriste përhapin ideologjitë dhe narrativët e tyre dhe në të njëjtën kohë janë të gatshme për tu përballur me këto fenomene. Për arritjen e këtij objektivit specifik, do të ndërmerren veprime në drejtim të:

- Rritjes së ndërgjegjësimit të akterëve të përfshirë në lidhje me rreziqet e paraqitura nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi dhe nxitja e qasjeve bashkëpunuese për ta luftuar atë;
- Ngritjen e kapaciteteve të palëve të interesuara në ndërmarrjen e aktiviteteve për luftimin e ideologjive ekstremiste;
- Krijimin e një dokumenti strategjik për komunikimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe komunitetin me qëllim të ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me rreziqet që lidhen me terrorizmin, përfshirë fushatave efektive kundër narrativave ekstremiste;
- Përfshirje më të madhe të nivelit lokal dhe shoqërisë civile.

3. Ndërhyrja e hershme për të mbrojtur dhe mbështetur ata që janë më të rrezikuar nga radikalizmi

Ky objektivi specifik synon të nxisë një bashkëpunim më të madh midis komunitetit, autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të tjera për të zhvilluar dhe ofruar intervenime mbrojtëse për individët që janë lehtë cak dhe mund të tërhiqen nga terrorizmi. Një rol të rëndësishëm në identifikimin e hershëm të atyre që janë duke u radikalizuar duhet ta kenë prindërit, familja, shoqëria, mësuesit, pedagogët dhe psikologët, punonjësit socialë, punonjësit e zyrave për punësim.

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale - me institucionet arsimore, familjet, grupet e komuniteteve, bashkësitë fetare, OJQ-të dhe shoqërinë civile - në përgjithësi është thelbësor për identifikimin e hershëm të individëve që mund të përfshihen në ideologji dhe/apo narrativa ekstremiste.

Për arritjen e këtij objektivi specifik, do të ndërmerren veprime në drejtim të:

- Identifikimit të popullatës së synuar për radikalizëm, si dhe faktorëve shtytës dhe tërheqës që kontribuojnë në procesin e radikalizimit;
- Rritjes së ndërgjegjësimit të institucioneve dhe ngritjen e kapaciteteve me qëllim të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe kuptimin e proceseve të radikalizimit;
- Rritja e rolit të familjes në identifikimin e ndryshimeve në sjelljen e anëtarëve të familjes së tyre, të cilat mund të lidhen me një proces radikalizimit;
- Forcimit të partneritetit me nivelin lokal për të krijuar mekanizma të reagimit;
- Rritjes së besimit mes komunitetin dhe institucioneve të zbatimit të ligjit;
- Rritjes së përfshirjes së nivelit lokal në zbatimin e masave për ngritjen e sigurisë në bashkësi dhe parandalimin e terrorizimit.
- Fuqizimin e grupeve përfaqësuese të grave në fushën e identifikimit të hershëm.

4. Rehabilitimi, riintegrimi dhe shkëputja

Ky objektiv specifik synon të krijojë një ambient të favorshëm për procesin e Rehabilitimit dhe Riintegritimit, si dhe të ofrojë mbështetje për ata që tashmë janë duke u përfshirë ose që janë përfshirë në terrorizëm në mënyrë që ata të shkëputen dhe rehabilitohen, si dhe për të reduktuar dhe parandaluar recidivizmin. Në fokus do të jetë ofrimi i programeve të qëndrueshme kualitative dhe gjithëpërfshirëse me qëllim të riintegritimit të personave potencialisht të radikalizuar.

Për arritjen e këtij objektivi specifik, do të ndërmerren veprime në drejtim të:

- Ofrimit të mbështetjes për individët e radikalizuar në mënyrë që ata të braktisin ideologjitë terroriste dhe të heqin dorë nga dhuna;
- Ndërhyrjes/përmirësimit të programeve të rehabilitimit brenda sistemit korrektues për rrezikun që paraqesin të dënuarit për veprat penale kundër terrorizmit ose të dyshuarit për terrorizëm dhe ngritja e kapaciteteve në sistemin për rehabilitimin e të burgosurve të tillë;
- Ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe ofrimi i programeve mbështetëse për personat nën mbikëqyrjen e SHSK-se e të cilët janë me histori të terrorizmit;
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve të nivelit lokal për zbatimin e programit të Rehabilitimit dhe Riintegritimit;
- Fuqizimi i diskutimit në mes të akterëve institucional dhe shoqëror në analizimin e sukseseve të programeve të Rehabilitimit dhe Riintegritimit.

Treguesit për matjen e përfomances të objektivave specifike:

OS	Treguesi i rezultatit	Burimi	Vlera bazë	Caku 2025	Caku 2028
1.1	Numri i personave potencial për radikalizëm të identifikuar dhe të trajtuar	MPB	3 (2022)	Përqindja e personave të trajtuar nga të radikalizuarit e identifikuar në fund të 2025	Përqindja e personave të trajtuar nga të radikalizuarit e identifikuar në fund të 2028
	Numri i zyrtarëve të trajnuar me njohuri për identifikim dhe adresim të rrethanave që qojnë në ekstremizmin e dhunshëm	MPB, Komunitat	Gjendja në 2022	>70	>110

	dhe radikalizëm që shpie në terrorizëm				
1.2	Numri i kundër narrativëve	MPB	Gjendja në 2022	>4	>6
	Numri i forumeve për dialog ndërfaqetarak për rajone	MPB	Gjendja në 2022	>4	>6
1.3	Numri i shkollave që kanë psikologë dhe staf profesional për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit	MPB	Gjendja në 2022	>20	>30
	Numri i të burgosurve të trajtuar gjatë vuajtjes së dënimit	SHKK	Gjendja në 2022	70%	80%
1.4	Përqindja e personave të identifikuar që përfshihen në Programin e MPB-së për Rehabilitim dhe Riintegrim	MPB	71% (2022)	Më shumë se 75%	Më shumë se 80%
	Numri i subjekteve dhe komunitetit pritës që marrin subvencione/grante	MPB	54 gjatë 2022	Sipas nevojës/kërkësës	Sipas nevojës/kërkesës

7.2. MBROJTJA

Sa i përket fushës së mbrojtjes, institucionet e Republikës së Kosovës kanë arritur progres të mirë, përmes avancimit të kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit të ngushtë me partnerët ndërkombëtar. Korniza ligjore për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Gjithashtu korniza institucionale është e rregulluar mirë dhe e aftë për të ofruar siguri. Megjithë arritjet e deritashme sa i përket aftësive mbrojtëse, institucionet e Republikës së Kosovës, duke i parë edhe format e reja të kërcënimeve hibride e zhvillimet teknologjike, do të vazhdojnë të ndërmarrin veprime për avancimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për rritjen e aftësive mbrojtëse.

Andaj, synimi i këtij objektivi strategjik është forcimi i aftësive mbrojtëse nga sulmet terroriste, përkatësisht kërcënimin nga terrorizmi ndaj Republikës së Kosovës apo ndaj interesave të saj në rajon dhe më gjerë. Përveç forcimit të aftësive mbrojtëse, kjo nënkupton edhe minimizimin e cenueshmërisë nga ky fenomen.

Treguesi i ndikimit	Burimi	Përshkrimi i treguesit	Vlera bazë dhe renditja e vendit 2022	Caku 2025	Caku 2028
---------------------	--------	------------------------	---------------------------------------	-----------	-----------

Aktiviteti terrorist	Indeksi Global për Paqe	Llogaritja e bazuar në një mesatare të përgjithshme të pesë viteve të fundit të numrit të viktimave, të plagosurve dhe dëmeve materiale të shkaktuara nga terrorizmi	1,5/5	<1,5/5	1/5
Ndikimi i terrorizmit	Indeksi Global i Terrorizmit	Indeksi Global i Terrorizmit është një masë e përbërë nga katër tregues: incidente, viktima, lëndime dhe dëme materiale. Për të matur ndikimin e terrorizmit, zbatohet një mesatare pesëvjeçare	0,291/10	0,15/10	0/10

Në kuadër të objektivit strategjik të Mbrojtjes, janë katër objektiva specifike, si më poshtë:

1. Mbrojtja e qytetarëve dhe pronës të Republikës së Kosovës që mund të jenë në shënjestër nga sulmet terroriste;
2. Mbrojtja e mallrave/materialeve me rrezikshmëri të lartë dhe mallrave strategjike që kërkojnë mbrojtje të veçantë;
3. Mbrojtja e Infrastrukturës kritike;
4. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë për mbrojtjen nga terrorizimi;

OS	Treguesi i rezultatit	Burimi	Vlera bazë	Caku 2025	Caku 2028
2.1	Numri i incidenteve	Indeksi Global i Terrorizmit	0	0	0
2.2	Krijimi i listës me materiale me rrezikshmëri të lartë të cilat kërkojnë mbrojtje të veçantë	MPB	Gjendja në 2022	Krijimi i listës	Përditësimi i listës
2.3	Numri i incidenteve ndaj infrastrukturës kritike	MPB, PK	Gjendja në 2022	0	0
	Identifikimi i infrastrukturës kritike	MPB	Gjendja në 2022	Së paku 3 sektor të identifikuar	Së paku 5 sektor të identifikuar
2.4	Numri i zyrtarëve të trajnuar	Raportet për zbatimin e Strategjisë për	Gjendja në 2022	>15	>20

		parandalimin dhe luftimin e terrorizmit			
	Numri i bashkëpunimeve ndërkombëtare për ngritje të kapaciteteve	Raportet për zbatimin e Strategjisë për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit	Gjendja në 2022	>5	>10

7.3. NDJEKJA

Institucionet e Republikës së Kosovës do të vazhdojnë t'i trajtojnë me prioritet ndjekjen dhe hetimin e veprave të lidhura me terrorizmin. Në raportin vjetor të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve, Kosova vlerësohet si një ndër shtetet më aktive në Ballkan për ndjekjen penale të individëve të dyshuar për kryerjen ose mbështetjen e aktiviteteve terroriste.¹⁰ Megjithë suksesin e arritur, institucionet do të vazhdojnë me angazhimin e tyre dhe ngritjen e kapaciteteve në zbulimin dhe ndjekjen e suksesshme të kryerësve të veprave terroriste dhe financimit të terrorizmit, me qëllim të eliminimit të kërcënimit nga terrorizmi dhe ofrimit të një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët.

Qëllimi i objektivit strategjik të Ndjekjes është identifikimi, hetimi dhe zbulimi i veprave penale të terrorizmit dhe financimit të terrorizmit dhe sjellja para drejtësisë e individëve ose grupeve që paraqesin kërcënim terrorist ose kryejnë akte terroriste.

Treguesi i ndikimit	Burimi	Përshkrimi i treguesit	Vlera bazë dhe renditja e vendit 2022	Caku 2025	Caku 2028
Siguria (Indeksi Global për Paqe)	MPB	Një indeks i përbërë që mat paqen e vendeve, i përbërë nga 23 tregues sasiore dhe cilësorë, secili i peshuar në një shkallë nga 1-5. Sa më i ulët të jetë rezultati, aq më i qetë është vendi.	1,9/5	1,5/5	1/5

Në kuadër të objektivit strategjik të Ndjekjes, janë pesë objektiva specifike, si më poshtë:

¹⁰ https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/07/Country_Reports_on_Terrorism_2020.pdf

1. Pengimi dhe hetimi i individëve dhe grupeve që ndikojnë, rekrutojnë, financojnë, mbështesin, planifikojnë sulme terroriste si dhe tentojnë të ndërtojnë legjitimitet brenda territorit të Republikës së Kosovës;
2. Forcimi i kapaciteteve institucionale për ndjekje penale dhe procedim efektiv;
3. Luftimi i financimit të terrorizmit;
4. Avancimi i politikave për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit;
5. Fuqizimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar.

OS	Treguesi i rezultatit	Burimi	Vlera bazë	Caku 2025	Caku 2028
3.1	Aktiviteti terrorist	(Indeksi Global për Paqe)	1/5	<1/5	<1/5
	Numri i rasteve të nisura nga Policia e Kosovës	Policia e Kosovës	Numri gjatë 2022	Numri i rasteve deri në fund të 2025	Numri i rasteve deri në fund të 2028
	Përqindja e aktakuzave ne përpjesëtime me rastet e iniciuara nga Policia	Prokuroria	Përqindja gjatë 2022	Përqindja gjatë 2025	Përqindja gjatë 2028
3.2	Numri policëve të trajnuar me trajnime të specializuara	Policia e Kosovës		>10	>15
3.3	Numri i zyrtarëve të trajnuar për luftimin e financimit të terrorizmit	Policia e Kosovës, NJIF, Prokuroria		>10	>15
	Numri i hetimeve të integruara financiare për financim të terrorizmit	Policia e Kosovës		Numri i rasteve deri në fund të 2025	Numri i rasteve deri në fund të 2028
3.4	Korniza ligjore e rishikuar dhe e ndryshuar sipas nevojës	MPB	n/n	Të paktën 2 akte janë rishikuar dhe ndryshuar deri në fund të vitit 2025	Të paktën 4 akte janë rishikuar dhe ndryshuar deri në fund të vitit 2028
3.5	Pjesëmarrja në nisma rajonale dhe ndërkombëtare	MPB		>4	>6
	Numri i bashkëpunimeve me EUROPOL	Policia e Kosovës		Numri i informatave	Numri i informata

				të shkëmbyera deri në fund të 2025	ve të shkëmbyera deri në fund të 2028
	Numri i bashkëpunimeve me shtetet fqinje në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit	MPB, Raportet për zbatimin e Strategjisë për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit		Numri i bashkëpunimeve deri në fund të 2025	Numri i bashkëpunimeve deri në fund të 2028

7.4. REAGIMI

Synimi kryesor i këtij objektivi është përgatitja e institucioneve përkatëse për t'iu përgjigjur sulmeve terroriste. Pasi të ketë ndodhur një sulm terrorist, është e nevojshme të merren veprime të shpejta për të minimizuar ndikimin e sulmit, ofrimin e ndihmës për viktimat si dhe kryerjen e hetimit dhe ndjekjen e shpejtë të autorëve. Për këtë qëllim është e nevojshme të sigurohet korniza e duhur ligjore, kapacitetet njerëzore e teknike si dhe koordinim i mirëfilltë mes institucioneve përkatëse. Përgatitja dhe reagimi efektiv janë vendimtar për të shpëtuar jetë dhe për të minimizuar dëmet dhe pasojat e mundshme.

Andaj, përmes këtij objektivi Strategjia ka për qëllim përgatitjen e institucioneve të Republikës së Kosovës për menaxhimin dhe minimizimin e pasojave të sulmeve terroriste, duke përmirësuar aftësinë për t'u përballur me pasojat, koordinimin e reagimit, mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave.

Treguesi i ndikimit	Burimi	Përshkrimi i treguesit	Vlera bazë dhe renditja e vendit 2022	Caku 2025	Caku 2028
Gatishmëria për reagim	Banka Botërore dhe Njësia Globale për Reduktim të Fatkeqësive dhe	Vlerëson gatishmërinë e një vendi për t'u përballë me gjendje emergjente duke analizuar kornizën ligjore, institucionale, informative si dhe pajisjet dhe personelin	174 nga 360 (2020)	184/360	194/360

	Rikuperim Global				
--	---------------------	--	--	--	--

Në kuadër të objektivit strategjik të Reagimit, janë katër objektiva specifike, si më poshtë:

1. Gatishmëri për reagim dhe menaxhim të situatave me qëllim të minimizimit të pasojave në rast të ndonjë sulmi të mundshëm terrorist;
2. Fuqizimi i kapaciteteve dhe aftësisë reaguese të institucioneve përkatëse për gatishmëri dhe reagim;
3. Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve vendore dhe bashkëpunimin ndërkombëtar;
4. Ngritja e kapaciteteve të mbrojtjes civile.

OS	Treguesi i rezultatit	Burimi	Vlera bazë	Caku 2025	Caku 2028
4.1	Strukturat organizative për menaxhimin e incidentit	Banka Botërore dhe	2/5	2.5/5	3/5
	Sistemet e paralajmërimit të hershëm	Njësia Globale për Reduktim të Fatkeqësive dhe Rikuperim Global	3.50/5	3.75/5	4/5
	Qendrat e operacioneve emergjente		3.50/5	3.75/5	4/5
4.2	Trajnimi dhe ndërtimi i njohurive	Banka Botërore dhe	2.75/5	3/5	3.25/5
	Ushtrime dhe stërvitje	Njësia Globale për Reduktim të Fatkeqësive dhe Rikuperim Global	3.50	3.75/5	4/5
	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit		2/5	2.7/5	3.2/5
4.3	Hartimi i raporteve për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor	MPB, Komisioni Evropian	2 raporte	2 raporte	2 raporte
4.4	Numri i zyrtarëve të rekrutuar për mbrojtje civile	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	Gjendja në vitin 2022	>30	>40
	Numri i intervenimeve			Numri i intervenimeve e deri në fund të 2024	Numri i intervenimeve deri në fund të 2025

8. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË

Roli i Sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit

Procesi i zbatimit të Strategjisë synon përmbushjen e objektivave strategjike dhe specifike. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve do të jetë pjesë integrale e procesit të strategjisë, si dhe elementë kyç në zbatimin e saj, përfshirë vlerësimin e ndikimit të Strategjisë.

Monitorimi do të konsistojë në mbledhjen e vazhdueshme dhe sistematike të të dhënave për të matur progresin dhe zbatimin e Planit të Veprimit. Vlerësimi do të bëhet në baza të rregullta periodike, vjetore, por edhe "ad hoc", përmes së cilit do të vlerësohet zbatimi i Planit të Veprimit dhe ndikimi i tij në praktikë. Procesi i vlerësimit do të rezultojë në rishikimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit, duke ofruar planifikimin e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin efektiv të objektivave strategjike dhe përafrimin me tendencat e kërcënimeve vendore dhe globale.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit janë:

- Kapaciteti institucional;
- Treguesit e monitorimit gjatë dhe në fund të periudhës trevjeçare; dhe
- Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse.

Kapacitetet institucionale për Monitorim dhe Vlerësim

Sistemi i Monitorimit dhe Vlerësimit do të zgjerohet për të mbuluar të gjitha institucionet përgjegjëse për arritjen e objektivave të përcaktuara në Strategji dhe në Planin e Veprimit:

- Koordinatori Kombëtar kundër Terrorizmit, si institucioni kryesor koordinues për arritjen e objektivave, do të monitorojë treguesit e Strategjisë për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit;
- Koordinatori Kombëtar kundër Terrorizmit do mbaj takime të rregullta dhe do të koordinojë procesin e asistencës së jashtme;
- Sekretariati i Strategjive rregullisht do të monitorojë zbatimin e Planit të Veprimit, duke mbledhur raporte tremujore, vjetore dhe ad-hoc, nga të gjitha institucionet relevante dhe do të prodhojë raporte analitike për zbatimin e strategjisë;
- Ministrinë, organet e zbatimit të ligjit dhe institucionet e tjera të listuara në Planin e Veprimit do të jenë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të caktuara për ministrinë e tyre ose institucionet e tyre vartëse. Këto institucione do të dorëzojnë raportet e tyre periodike në Sekretariatit për Strategji. Raportet do të dërgojnë edhe mekanizmat jashtë-institucional të cilët janë të paraparë në Planin e Veprimit.

- Organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare do të marrin pjesë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë duke forcuar gjithëpërfshirjen, transparencën dhe llogaridhënien;
- Vlerësimi i ndikimit të Strategjisë në periudha 2 vjeçare do të bëhet nga një subjekt i jashtëm.

Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit

Çdo aktivitet sipas planit të veprimit ka tregues cilësorë dhe sasiorë përkatës që do t'i shërbejnë procesit të monitorimit dhe vlerësimit.

Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit

- Të dhëna administrative/statistikore nga akterë të ndryshëm përkatës;
- Raporti vjetor i zbatimit të strategjisë dhe raporte të tjera ad-hoc;
- Raporte të jashtme nga organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare;
- Vlerësimi i ndikimit të Strategjisë në periudha 2 vjeçare nga një subjekt i jashtëm;
- Sondazhe.

9. Korniza ligjore dhe institucionale

9.1. Korniza ligjore

Në fushën e terrorizmit, Republika e Kosovës ka në zbatim një bazë të gjerë ligjore, e cila përfshin por nuk kufizohet në:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji Nr.05/L-002 për Ndalimin e Bashkimit në Konflikte të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit
- Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit
- Ligji nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës
- Ligji nr.03/L -166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik
- Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike
- Ligji nr.05/L-030 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike
- Ligji nr.06/L - 082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë
- Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike
- Ligji nr. 03/L063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë
- Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L -129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/l-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
- Ligji nr. 03/ L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare

- Ligji nr. 04/L-213 për Ndhimën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale
- Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare
- Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror
- Ligji nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë
- Ligji nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike
- Ligji nr.04/L -004 për Shërbimet Private të Sigurisë
- Ligji nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës
- Kodi nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizës i Kosovës
- Ligji nr. 04/L-099 për Ndryshim-Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, nr. 03/1-109
- Ligji nr.03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë
- Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale
- Ligji nr.03/L-122 për Shërbim të Jashtëm të Republikës së Kosovës
- Ligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat
- Ligji nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit
- Ligji nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës
- Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës¹¹
- Ligji nr.04/L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve
- Ligji nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
- Ligji nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfutur me Vepër Penale
- Kodi nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur
- Rregullore nr.18/2011 për Shpërndarjen dhe Transferimin e Informacionit të Klasifikuar¹²
- Ligji nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit
- Ligji nr. 05/L-022 për Armë
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligji Nr.08/L-173 për sigurinë kibernetike.

9.2. Korniza institucionale

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat të cilët janë të përfshirë në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit në Kosovë. Kompetencat e secilit institucion relevant të

¹¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2526>

¹² <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10554>

përfshirë në hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushën kundër terrorizmit janë mirëpo nuk kufizohen në vetëm këto institucione:

Ministria e Punëve të Brendshme

MPB është institucioni përgjegjës qeveritar që udhëheq hartimin dhe monitorimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e sigurisë së përgjithshme si dhe terrorizmit. Përmes mekanizmave dhe agjencive të saja, MPB ndërmer aktivitetet në parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve terroriste.

Koordinatori Nacional për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit

Koordinatori Nacional për parandalimin dhe luftimin e Terrorizmit është Ministri i Punëve të Brendshme, ose personi i autorizuar nga ai. Koordinatori Nacional është përgjegjës:

- Të koordinojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportojë për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe çështjeve lidhur me parandalimin dhe luftimin e terrorizmit;
- Të këshilloj Kryeministrin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me luftimin e terrorizmit, dhe ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin;
- Të koordinojë aktivitetet e të gjitha institucioneve relevante në çështjet e luftimit të terrorizmit dhe masave kundër ekstremizmit të dhunshëm;
- Të pranojë raporte informuese nga institucionet relevante, me qëllim të përgatitjes së dokumenteve strategjike analitike lidhur me luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmin e dhunshëm;
- Është përgjegjës dhe pikë kontakti ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, duke përfshirë koordinimin e organizimeve, donacioneve dhe projekteve vendore dhe ndërkombëtare;
- Të koordinojë të gjitha raportimet rreth përgjegjësive dhe obligimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës në nismat rajonale dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjet e luftimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Sekretariati i Strategjive

Sekretariati i Strategjive në MPB ka për detyrë të monitorojë në baza të rregullta zbatimin e strategjisë duke mbledhur dhe analizuar të dhëna rreth zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit, si dhe duke hartuar raportet periodike dhe vlerësuese për Koordinatorin Nacional. Përveç këtyre, Sekretariati do të ndihmojë Koordinatorin Nacional për koordinim e strategjisë dhe komunikimin me palët e interesit.

Policia e Kosovës

Si agjenci e zbatimit e ligjit në kuadër të MPB-së, PK ka përgjegjësinë kryesore në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, përmes Drejtorisë kundër Terrorizmit dhe strukturave tjera mbështetëse në kuadër të Policisë së Kosovës.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë

Si agjenci për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, AKF ka përgjegjësi në kryerjen e ekspertizave forenzike profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtare si dhe në menaxhimin databazave forenzike.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent

Si agjenci në kuadër të MPB-së, AME ka përgjegjësi në zhvillimin e të gjitha masave për t'u përgatitur, mbrojtur, reaguuar dhe rimëkëmbur nga të gjitha rreziqet e mundshme, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë

AKI bën identifikimin e kërcënimeve që rrezikojnë sigurinë e Kosovës, integritetin territorial, integritetin e institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale në dëm të Kosovës, duke përfshi nxitjen, ndihmën ose shtytjen dhe përkrahjen e terrorizmit. AKI është agjenci për siguri dhe inteligjencë e cila mbledh, analizon dhe shpërndan produkte inteligjente në mënyrë të shpejtë, të ligjshme dhe të përgjegjshme tek Presidenti, Kryeministri dhe Institucionet tjera kompetente.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KGJK zhvillon politika efektive për sistemin gjyqësor për trajtim më efikas të rasteve të terrorizmit dhe dënimin e personave të përfshirë në aktivitete terroriste. KGJK siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor në vendimmarrje.

Sistemi Gjyqësor

Rastet e terrorizmit në Kosovë trajtohen nga në tri nivele: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Supreme, kurse gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, pa ndikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik përfshirë edhe organet publike.

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Këshilli zhvillon politika efektive për sistemin prokurorial për hetimin dhe përndjekjen më efikase të personave të përfshirë në aktivitete terroriste. KPK-ja siguron një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm.

Prokuroria e Shtetit

Është institucion i pavarur, me autoritet dhe me përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të dyshuar dhe akuzuar për përfshirjen e tyre në aktivitete terroriste PSRK ka kompetencë të veçantë që të hetojë dhe të ndjekë veprat penale të natyrës së veçantë, përfshirë edhe kryerjen, përgatitjen, bashkëpunimin dhe lehtësimin e kryerjen së veprave penale të terrorizmit.

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës

Sekretariati, si pjesë përbërëse e Këshillit të Sigurisë së Kosovës bën përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Këshillin e Sigurisë së Kosovës që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë. Duke pasur parasysh rrezikun që aktivitetet terroriste paraqesin për sigurinë e Kosovës, ky sekretariat është po ashtu i përfshirë në koordinimin e hartimit të strategjisë nacionale të sigurisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve, instrumentet e politikave dhe hulumtimit.

Ministria e Drejtësisë

MD përgatitë dhe zhvillon legjislacionin në fushën e drejtësisë, si dhe koordinon dhe zhvillon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Gjithashtu, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me të gjitha ministritë, agjencitë dhe komunitetet fetare të cilat në forma të ndryshme ndërlidhen me procesin e deradikalizimit dhe risocializimit të të dënuarve për terrorizëm.

Shërbimi Korrektues i Kosovës

ShKK, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e drejtësisë, synon të korrektojë dhe të risocializojë personat e dënuar për aktivitete kriminale me theks të veçantë në parandalimin e radikalizimit në burgje duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religionin, si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë.

Shërbimi Sprovues i Kosovës

SHSK është përgjegjës për Ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrjen, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin e të gjithë personave që kanë kryer vepra penale të ndëshkueshme sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Po ashtu, SHSK ka për mandat edhe riintegrimin dhe rehabilitimin e personave të liruar me kusht nga burgju.

Ministria e Mbrojtjes

MM përmes mekanizmave të saj ndihmon institucionet vendore në parandalimin e terrorizmit, ndërsa me njësitet e saja merr pjesë aktive në mbrojtje dhe reagim ndaj sulmeve të mundshëm terroriste.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MFPT do të ketë rol aktiv dhe bashkëpunues me të gjitha institucionet e ndikuar nga Plani i Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie, duke u përkujdesur që aktivitetet dhe objektivat e parapara të realizohen brenda ndarjeve të rregullta buxhetore.

Dogana e Kosovës

Dogana e Kosovës, duke ushtruar funksionin e vet të kontrollit të mallrave dhe personave në pikat e kalimit kufitar dhe brenda territorit të Kosovës kontribuojnë në parandalimin, identifikimin, raportimin, hetimin dhe bllokimin e burimeve të financimit të aktiviteteve terroriste.

Njësia e Inteligjencës Financiare

Si agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave, NJIF është përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

ARKEP është organi rregullator, i cili zbaton dhe mbikëqyrë kornizën rregullatore të përcaktuar nga ligji për Komunikime Elektronike, nga ligji për shërbimet postare, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

MASHTI luan rëndësishëm në fushën e parandalimit dhe vetëdijesimit nëpërmjet hartimit të kurrikulave, organizimit të aktiviteteve vetëdijësuese në parandalimin e terrorizmit.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës luan rol të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit, duke pasur për mision (përveç tjerave) formulimin dhe zbatimin e politikës së jashtme, zhvillimin dhe bashkërendimin e politikave në raport me vendet tjera si dhe përgjegjësi të rëndësishme të koordinimit të dikastereve qeveritare dhe shtetërore që kanë të bëjnë me çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Krijon politikën kulturore, rinore, sportive dhe të trashëgimisë, harton programe për shqyrtimin e nevojave të të rinjve dhe përkrahjen e tyre dhe në veçanti identifikimin dhe përkrahjen e grupeve specifike të rrezikuara. Krijon programe për ngritjen e nivelit të komunikimit kulturor dhe bashkëjetesës mes kulturave të të gjitha komuniteteve etnike, fetare apo gjuhësore në vend,

duke përfshirë edhe promovimin kulturor dhe bashkëpunimin në fushën e kulturë, rinisë dhe sportit.

Agjencia e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Si organ i pavarur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, AKMRRSB është agjenci e specializuar për zbatimin e politikave dhe standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Zyra për mbrojtjen dhe ndihmë të viktimave

Zyra për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave (ZMNV) është zyre e pavarur që funksionin në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. ZMNV është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për viktimat gjatë procedurave ligjore, informimin për të drejtat e tyre si dhe përfaqësimin e interesave të tyre në sistemin penal të Kosovës. Zyra po ashtu asiston viktimat në plotësimin e kërkesave për kompensim në procedurat kriminale dhe aplikimin e kompensimeve shtetërore.

Komisioni i Pavarur i Mediave

KPM është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

KMSHK është një trup vetërregullues i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara. Misioni i tij mbështetet mbi bindjet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Agjencia për Privatësi dhe Informacion

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) është agjenci e pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore, është ndër parimet bazë të zbatimit të kësaj Strategjie, kështu AIP ka rol të rëndësishëm me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike.

Asociacioni i Komunave të Kosovës

AKK-ja është organizatë jopfitabile, që i përfaqëson interesat e përgjithshme të autoriteteve lokale. Kjo Strategji synon një përfshirje më të madhe të nivelit lokal në arritjen e qëllimeve të saja, andaj AKK do të luaj një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe ndërveprimin e autoriteteve lokale.

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit

ASHI, si agjenci në kuadër të MPB është organ qendror i administratës shtetërore për zhvillimin dhe zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, për institucionet e Republikës së Kosovës.